



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 44, Datë 31.03.2022

PËR MIRATIMIN E PROCES VERBALIT TË MBLEDHJES TË DATES 24.02.2022
TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 24.02.2022, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 24.02.2022 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erjon NEXHIPI



PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATË 24.02.2022

~~Kryesuesi i mbledhjes është kryetari i Këshillit z.Erjon Nexhipi~~

Ora e hapjes së mbledhjes: 13:00

Zhvillimi i mbledhjes : në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 21

Sekretari i Këshillit deklaroi kuorumin prej 21 këshilltarësh.

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë z.Sotiraq Filo dhe drejtorë të ekzekutivit

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 2

Pika 1 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Pika e parë e rendit të ditës, pikërisht miratimi i rendit të ditës ku pas pikës 7 të tij propozoj të përfshihet çështja e ngritjes dhe përbërjes së Komitetit Këshillimor për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit. Ka ndonjë diskutim për rendin e ditës? E hedhim në votim bashkë me shtesën e propozuar.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 2 e rendit të ditës

PËR MIRATIMIN E PROÇESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KALUAR.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Është shpërndarë me e-mail materiali i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, pra pika 2 e rendit të ditës. Ka diçka për të shtuar mbi procesverbalin e mbledhjes së kaluar?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 3 e rendit të ditës

PËR SHQYRTIMIN E MBARIMIT TË MANDATIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT
Z.PETRAQ PREMTI.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mandateve z.Shkëlqim Kajmaku, mund të vazhdoni.

Këshilltari Sh.Kajmaku: Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, gërma (dh) e pikës 4 të nenit 49 si dhe gërma (j) e nenit 54, në zbatim dhe të gërmës (e) të pikës 1 të nenit 15, të Rregullores së Këshillit Bashkiak Korçë, miratuar me Vendimin nr.80 datë 30.07.2020” Për miratimin e Rregullores të Këshillit Bashkiak Korçë”, Këshilli i Bashkisë propozon miratimin e mbarimit të mandatit përpara afatit të këshilltarit z.Petraq Premti, për shkak se ky këshilltar ka ndërruar jetë në datën 10.02.2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kalojmë në votim.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 4 e rendit të ditës

MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR
BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR
PERIUDHËN 1 – 31 JANAR 2022.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj Irena Nikaj mund të merrni fjalën tuaj.

Këshilltare I.Nikaj: Propozoj dhënie e ndihmës ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike dhe nga fondi i buxhetit vendor për periudhën 1-31 janar 2022. Për muajin Janar, janë 6 familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar, ku fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike është një fond i cili i shtohet çeljes faktike nga lista e përfituesve të ndihmës ekonomike, të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit. Këto familje, përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, “Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme” konkretisht për ato familje të cilat kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni. Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi, për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane, sipas kriterëve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me vendim nr. 5 për kriteret e buxhetit vendor dhe vendim nr.4 për kriteret e 6%, datë 27.01.2022. Për të gjitha këto arsye, Administratorët e sektorit të pagesave, i propozojnë Këshillit të Bashkisë që gjatë muajit Janar: për muajin Janar 2022, është në dispozicioni fondi prej 224.480 lekë si 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën

ekonomike, nga sistemi i pikëzimit; nga ky fond, përfitojnë 6 familje, të përzgjedhura sipas kriterëve specifike të miratuara, në shumën 18.018 lekë; po nga ky fond përfitojnë kompensim të energjisë elektrike 5 familje, në shumën 6.440 lekë; pagesa totale nga 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, plus energji, është 24.458 lekë; të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, sipas kriterëve specifike të miratuara 24 familje, me fond prej 69.168 lekë. Edhe një sqarim që më është bërë nga Drejtoria e Kujdesit Social mbi numrin e familjeve që përfitojnë kompensim është i vogël, sepse e tillë është procedura e përcaktuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Ju ftoj të gjithëve për miratim të kësaj pike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Kalojmë në votim.
Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 5 e rendit të ditës

MBI MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE PËR PROGRAMIN "BANESA ME KOSTO TË ULËT".

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Përsëri Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjimore, Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut, znj Irena Nikaj mund të vazhdoni.

Këshilltare I.Nikaj: Propozoj miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve për programin "Banesa me kosto të ulët". Konkretisht kemi të përcaktuara kriteret e pikëzimit që ndahen në kushtet e strehimit me 20 pikë, kushtet familjare me 20 pikë, kushtet sociale me 40 pikë dhe ato ekonomike me 20 pikë. Relacioni është i qartë. Ju ftoj për miratim të kësaj pike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka nga këshilltarët për të shtuar? Kalojmë në votim.
Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 6 e rendit të ditës

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 150, DATË 22.12.2022 TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË "PËR MIRATIMIN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022 NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Arsimit, Sporteve dhe Çlodhjes, znj.Edlira Mitrë mund të vazhdoni.

Këshilltare E.Mitre: Në mbledhjen e 22.12.2021 ne kemi miratuar një listë me nxënësit që përfitonin ndihmë me anë të bursave në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 666 dt.10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e krifereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit para universitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, si dhe mbështetur në shkresën Nr. 5204 Prot, dt 24.09.2021 “Për planifikimin e numrit të bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2021-2022”.Ndërkohë sot që ne flasim kemi 5 nxënës që nuk kanë frekuentuar shkollën asnjë ditë, ku 4 nxënës janë nga shkollat 9 vjeçare dhe 1 nxënës nga shkolla e mesme që do të zëvendësohen me qëllim që lista që kalojë e plotë. Ju ftoj për miratim.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët apo ekzekutivi? Vazhdojmë me votimin.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Pika 7 e rendit të ditës

PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES SPECIFIKE ME MIE PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË FURNIZIMIT ME UJË.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë z.Gjergji Kristo mund të merrni fjalën.

Këshilltari Gj.Kristo: Në kuadër të reformës në sektorin e ujësjellës kanalizime, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i është drejtuar Bashkisë Korçë me shkresë nr.950 datë 28.01.2022, duke i këshilluar Bashkisë Korçë marrjen e autorizimit nga Këshilli Bashkiak, për lidhjen e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit, në territorin administrativ të Bashkisë Korçë. Sipas MIE, mbështetur në gjetjet dhe rekomandimet nga studimet e kryera nga partnerët ndërkombëtare që mbështesin Qeverinë Shqiptare, si dhe studimeve kombëtare në kuadër të përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimin e trajtimit e ujërave të ndotura urbane, rezulton se agregimi i shoqërive me numër të ulët të abonentëve duke krijuar shoqëri të konsoliduara me strukturë të përbashkët përmirëson: efijencën ekonomike nëpërmjet ekonomive të shkallës; akses në burimet ujore dhe menaxhimin të integruar të burimeve ujore; performancën e treguesve tregtar të UK; profesionalizmin dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerzore; ndikimin në mjedis; mundësitë për financim dhe rritje të kapitalit. Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjellës Kanalizime sh.a që do të krijohet, do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura urbane,

në territorin e hartës fizike të propozuar dhe do të funksionojë mbështetur në ligjin për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetës Kanalizime Sh.a do të ketë aksionere MIE dhe Bashkitë respektive që përfshihen në territorin e hartës së propozuar nga AKUM. Ju ftoj në miratim të kësaj pike.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ky propozim nga erdhur nga ekzekutivi?

Këshilltar Gj.Kristo: Po, me anë të shkresës së ministrisë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Të them diçka shkurtimisht edhe unë. Besoj se të gjithë e dini se një nga prioritetet tona këto vitet e fundit ka qënë sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm jo vetëm në qytet po kudo edhe në zonat rurale. E vërteta është se pavarësisht edhe ndihmës financiare që kanë marrë nga qeveria, ka shumë kompani ujësjetësash që nuk kanë një performancë të duhur dhe kjo ka bërë në fund që të mos garantojnë shërbimin për të cilin ata punojnë. Nga shkresa që na ka erdhur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ekonomisë tregohet se për shkak të një performancë të ulët nga kompanitë e ujësjetësave në bashki të tjera të Qarkut na sugjerohet të krijohet një bashkëpunim përtej Bashkisë, pra përtej territorit që mbulon një bashki, ku të bashkohen disa bashki. Për bashkinë tonë, unë mund të them diçka edhe jashtë këtij materiali, ne prej disa muajsh kemi qënë në bisedime për këtë çështje, me ministra, me kryetarët e bashkive të tjera apo edhe me drejtorët e ujësjetës-kanalizimeve dhe propozimi i deritanishëm është që Bashkia e Korçës të bashkohet me Bashkinë e Maliqit, Devollit, Kolonjës dhe Pustecit dhe do të jetë një kompani e përbashkët që do të kryejë funksionin e furnizimit me ujë të pijshëm, duke patur parasysh edhe përfitimet në kosto ekonomike që do të vijnë nga ky sistem. Në këtë proces analize që ka kryer Ministria më duhet ta them se ujësjetësi i Korçës është një nga ujësjetësat model, mos them më i miri në Shqipëri, edhe në drejtim të investimit edhe në drejtim të zgjidhjes së problematikave të furnizimit me ujë të pijshëm, edhe në drejtim të mirëmbajtjes së sistemeve, edhe në drejtim të efikasitetit të përdorimit të fondeve. Pra, jemi koshientë se jemi brenda standarteve jo vetëm shqipëtare, por edhe brenda standarteve kombëtare të stafit që kemi edhe për numër lidhjesh, ndërkohë që bashkitë e tjera kanë të tjera standarte operimi. Në këtë proces ujësjetësi i Korçës është marrë si shembull pozitiv, i cili duhet të ndiqet tani edhe në ujësjetësat e tjerë. Jemi në fazat e para të këtij procesi, ku kërkohet miratimi në Këshill bazuar mbi sugjerimin e MIE dhe pastaj për të vazhduar në hallkat e tjera të procesit ku sigurisht do të jetë edhe përgjegjësia jonë për të bërë kontrollin e nevojshëm të akteve ligjore dhe nënligjore.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ka diçka për të shtuar nga këshilltarët? Atëherë unë kam dy pyetje për të shtuar: së pari, duke ditur gjithë zhvillimin e rritjes të ujësjetësit në vitet e fundit, kemi një ndërmarrje ujësjetësi që mbulon edhe fshatrat, kështu mund të pyes sa është përmirësuar shërbimi i ujit dhe meqënëse kemi dy ndërmarrje bashkë, si ka evoluar, sa është përmirësuar ky shërbim dhe së dyti në rast se do flasim për një bashkim, nëse flitet për të patur resurse të përbashkëta dakort, por unë kam shqetësimin se mos ndoshta me këtë bashkim na vjen edhe një prishje e sistemit për të cilin jemi dalluar si shembull?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani përpara i takon pyetjes së parë unë nuk kam një informacion të detajuar për momentin, por di të them që nga viti 2015, kompania e ujësjetës-kanalizimeve ka patur një mbulim jo vetëm në qytet, por edhe në zonat rurale dhe gjithë treguesit kanë qënë gjithmonë në rritje në krahasim me periudhën kur zonat rurale na mbulohehin nga ujësjetësi i

fshatit. Nga ana teknike kemi investime shumë të mëdha që janë kryer në fshatrat e Bashkisë së Korçës, ku vetëm dy vitet e fundit është investuar në 15 apo 16 fshatra me projekte të mirëmenduara, me ndërhyrje nga më të voglat deri në ato më të mëdha duke përfshirë gjithë rrjetin brenda fshatit. Dy nga projektet më të mëdha janë ujësjellësi i Dvoranit dhe Kamenicës, ndërkohë është në proces ujësjellësi i Barçit dhe ai i Voskopit, ndërhyrje të tjera kemi në atë të Porodinës, Goskovës, Shamollit, lista është e gjatë. Sigurisht që problematika ka patur edhe ka, por gjithmonë duke ecur drejt përmirësimit edhe në bashkëpunim me ujësjellësin e Korçës, ka përmirësim në shërbim, po përmirësim ka edhe në aspektin ekonomik si në mbledhjen e taksave edhe në pagesat e tarifave që janë të ndryshme ato të qytetit nga zonat rurale. Si përfundim, performanca e ujësjellës-kanalizimeve Korçë ka qënë pozitive edhe pas bashkimit me rrjetin e shërbimit në zonat rurale. Për sa i takon pyetjes së dytë, ky ka qënë edhe një nga shqetësimet e mia që ja kam përcjellë edhe Ministres, pra sesi do të jetë impakti dhe cilësia e ujësjellësit tonë pas këtij bashkëpunimi dhe sigurisht që ky shqetësim do të jetë parasysh gjatë gjithë procesit. Prandaj iu thashë edhe më herët që jemi në hapat e parë të projektit dhe sigurisht unë si Kryetar Bashkie duhet të garantoj që kjo reformë e ujit, e cila nuk po ndodh vetëm në qarkun e Korçës, por po ndodh në gjithë Shqipërinë gjatë gjithë procesit të mos çënojë as cilësinë, as shërbimi i rrjetit tonë të ujësjellësit dhe as anën ekonomike të kompanisë. Pra, çdo qendër kostoje që do t'i takojë një bashkie duhet të garantojë se me tarifatat që do të mbledhë në territorin e saj të mbulojë kostot operacionale në këtë territor. Pastaj për pjesën e nevojave për investime, një prej argumentave që jep Ministria, por edhe një nga argumentat e mia nëse më pyesni sot është që qeveria ka marrë përsipër të mbulojë kostot e investimeve, edhe në bashkitë që kanë më tepër nevojë po edhe me ne si Bashki e Korçës, nuk është se ne kemi mbyllur pjesën e investimeve dhe nuk kemi më nevojë për mbështetje. Ne kemi marrë mbështetje të madhe nga qeveria, vetëm për furnizimin me ujë të pijshëm, 7 milion euro, ndërkohë që sfida më e madhe sidomos në zonat rurale po edhe në disa pjesë të qytetit të Korçës është zgjidhja e problemit të kanalizimeve, i cili ka kosto akoma më të mëdha sesa furnizimi me ujë të pijshëm, sepse nëse duhet të ndjekim standartet e BE-së, ku do vijë koha t'i plotësojmë ato standarte se në atë rrugë kemi hyrë, jo vetëm që duhet të bëjmë rrjetet e brendshme të kanalizimeve, por pastaj duhet të bëjmë dhe impiante trajtimi të ujërave të përdorura sipas çdo fshati apo grup fshatrash sipas studimit që do të bëhet. Këto kanë kosto shumë të mëdha. Një studim që kemi bërë ne për shembull me ujësjellës-kanalizimin tonë si Bashki për pjesën e kanalizimeve dhe mini impianteve ka shkuar në një shifër rreth 9 milion euro investime. Pra, nga ky projekt edhe ne do të kemi mundësi të marrim investime përtej këtyre investimeve që kemi realizuar deri tani me buxhetin që kemi patur. Edhe ne kemi nevojë për investime përtej buxhetit të Bashkisë sonë, është pozitive përfshira jonë edhe për përfitimet tona, por edhe sepse jemi kërkuar si shembull i eksperiencës sonë të rrjetit të ujësjellës-kanalizimit që ne kemi. Fakti që ne po merremi si shembull për gjithë modelin që kemi krijuar, si strukturë, organizim, menaxhim dhe gjithçka tjetër na jep të drejtën të jemi të gjithë krenarë për punën që është bërë dhe që është vlerësuar jo vetëm në Shqipëri, por edhe nga partnerë të rëndësishëm rajonalë apo Banka Botërore që na kanë mbështetur. Jemi histori suksesi dhe pse jo të japim kontributin tonë edhe tek të tjerët me anë të kësaj reforme. Pastaj për gjithë punën që do të vijojë sigurisht që secili do të mbajë peshën e tij të përgjegjësive në rast se çënohet e drejta e qytetarëve tanë. Ashtu si ne, çdo kryetar dhe Këshill Bashkiak duhet të mbajë përgjegjësitë e tij si në kosto si në menaxhim e kudo. Ka shumë për të folur, tema është shumë e gjërë, unë kam folur shumë, jam përfshirë shumë, di se kush janë kostot më të mëdha për shembull të këtyre ujësjellësve të tjerë, janë kostot e stafit dhe kostot e energjisë elektrike dhe këto janë ca gjëra që në rast se ka vullnet mund të reduktohen.

Këshilltari I.Nikaj: Doja të bëja një pyetje, kemi ne si Bashki borxhe për shkak të ujësjellësit?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Bilanci i kompanisë ujësjellës-kanalizime për fat është me një bilanc pozitiv, e vetmja marrëdhënie borxhesh ku nuk është vetëm kompania ujësjellës-kanalizime por edhe qeveria shqiptare është për kreditë që janë marrë për të realizuar investimet në kanalizimet në qytet. Pra, momentalisht kompania e ujësjellës-kanalizimeve është duke paguar kreditë që lidhen me furnizimin me ujë të pijshëm dhe për njërin nga projektet e kanalizimeve që është realizuar mos gaboj në tre faza.

Këshilltari I.Nikaj: Të them dy fjalë si vlerësim. Në materialin që është paraqitur me të zezë është shkruar "agregimi i shoqërive me numër të ulët të abonentëve duke krijuar shoqëri të konsoliduara me strukturë të përbashkët përmirëson: Efiçencën ekonomike nëpërmjet ekonomive të shkallës; akses në burimet ujore dhe menaxhimin të integruar të burimeve ujore; performancën e treguesve tregtar të UK; profesionalizmin dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerzore; ndikimin në mjedis; mundësitë për financim dhe rritje të kapitalit" ku nuk është marrë parasysh që ndërmarrjet kanë patur edhe probleme të ndryshme. Dyshimi im qëndron në faktin se mund të ishte punuar që nga data 18 kur është marrë vendimi për të shkuar në performancën e Korçës. Shqetësim sigurisht qëndron tek ndryshimi i kostove, por edhe më shqetësues është rritja e përqendrimit të pushtetit nga qeveria.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Ndërkohë që unë duke marrë çdo ditë shqetësime edhe nga qytetarët, doja të pyesja se sa % është përmirësuar cilësia e ujit në fshatra dhe në qytet falë gjithë këtyre investimeve që janë realizuar deri tani? Pra, nga gjithë kjo mbështetje me fonde nga qeveria, sa % e popullsisë janë mbuluar me shërbim nga ky rrjet, sa i dallueshëm është ky ndryshim apo edhe si variojnë oraret e furnizimit me ujë, si për qytetin ashtu edhe për zonat rurale? Na duhet t'i dimë këto sepse flitet për një projekt që përfshin gjithë zonën nga Leskoviku deri në Moglicë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për t'iu drejtuar fillimisht asaj që profesorja pyeti, unë e përmenda në fillim që ky organizim i ri që po bëhet ka qënë prioritet i qeverisë këto vitet e fundit dhe siç kemi marrë ne si Bashki këtë mbështetje me investime në vlerat e caktuara kanë marrë fonde për ujësjellësat të gjitha bashkitë e Qarkut të Korçës dhe gjithë bashkitë e Shqipërisë. Nga ana e infrastrukturës patjetër që janë më ndryshe këto vitet e fundit në krahasim me çfarë kanë qënë vitet më përpara, nuk është se s'ka patur mbështetje, apo nuk është se gjendja është njësoj apo më e keqe, të paktën nga pikëpamja e infrastrukturës. Pra, të gjithë kanë marrë investime. Ajo që është gjykuar se çalon është pjesa e menaxhimit, ku përtej pjesës së fondeve dhe investimeve, menaxhimi nuk ka qënë në nivelin e duhur dhe në menaxhim pastaj futen të gjitha stafit, pagat, cilësia e stafit, tarifat, performanca në mbledhjen e tarifave e me rradhë. Pra, kjo ka çaluar dhe tani kjo gjë propozohet të zgjidhet me anë të këtij organizimi. Tani ne mbahemi për modelin më të mirë, është përmendur edhe nga Kryeministri edhe nga përfaqësues të Bankës Botërore, si një nga ujësjellësat më të mirë në Ballkan dhe në Evropën Juglindore, nuk është merita ime, por duhet të ndihemi të gjithë krenarë që fal investimeve, gadishmërisë dhe vullnetit jemi bërë këta që jemi. Për të erdhur tek pyetjet e tjera, shërbimi i furnizimit me ujë është një nga kompetencat tona të drejtpërdrejta. Para vitit 2008, ujësjellësat menaxhoheshin nga qeveria dhe pas 2008 iu kaluan 100% bashkive. Tani nuk është se po kërkohet që ujësjellësat, menaxhimin e tyre ta marrë

100% qeveria, por po kërkohet që të krijohet një kompani e përbashkët që të ketë aksionere edhe bashkitë që do të jenë pjesë e projektit, po edhe qeveria, e cila ka mbështetur dhe do vazhdojë të mbështesë kompanitë e-ujësjellësive. Pra, ne nuk do të jemi 100% aksionerë, por do të kemi zërin tonë në këtë kompani. Për sa i përket pyetjes se si ka evoluar cilësia e ujit të pijshëm në zonat rurale, po edhe në qytet pas 2015 unë e dhashë përgjigjen edhe pse jo me shifra dhe %, pra po them që në 2-3 vitet e fundit është investuar në 16 fshatra, ku minimalisht këto 16 fshatra kanë të garantuar furnizimin me ujë të pijshëm. Në rast se kanë problematika në momente të caktuara kryesisht në sezonin e verës, vjen për shkak se përdorimi i ujit të pijshëm është më i madh për vaditje. Kjo është një nga gjërat që mund ta kemi përmirësuar po nuk e kemi zgjidhur plotësisht dhe na duhet edhe fokus më shumë, por kjo nuk heq meritat e investimeve dhe mbledhjes edhe të tarifave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Meqënëse kishim lënë një orar të caktuar për prezantim të iniciativës "Bashki Mike e Fëmijëve" e përfaqësuar nga UNICEF, kalojmë tek prezantimi dhe pastaj vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mund të them unë dy fjalë përpara sesa t'i kalojë fjala përfaqësuesve të UNICEF? Për mua është kënaqësi e madhe që të mirëpresim në qytetin e Korçës Drejtorin e Zyrës së UNICEF për Shqipërinë, z. Roberto, i cili do të prezantojë një nga iniciativat dhe projektet e përbashkëta midis Bashkisë dhe UNICEF Shqipëri me fokusin e tyre tek fëmijët. Nuk është projekti i vetëm që ne punojmë me UNICEF, po është padyshim projekti më i madh pasi kemi edhe disa eksperiencat të tjera pozitive bashkëpunimi me këtë organizatë të rëndësishme të Kombeve të Bashkuara, duke filluar me bashkëpunime për të mbështetur grupe të caktuara familjesh në periudhën e pandemisë, UNICEF-i ka qënë një nga organizatat ndërkombëtare që na është gjendur pranë dhe na ka asistuar me ndihmën dhe mbështetjen e tij, apo edhe me projektin pranë Bibliotekës së Re të qytetit para pak muajsh, i cili synon të afrojë fëmijët dhe të rinjtë me teknologjinë, por edhe ti mbrojë ata nga gjithë risqet që mund të vijnë po nga bota e teknologjisë. Ndërkohë për projektin që do të prezantohet sot, synohet të krijohet një qasje më integrale, më gjithëpërfshirëse e Bashkisë dhe UNICEF-it në raport duke parë nevojat dhe kërkesat e fëmijëve në disa drejtime i adresojmë më pas në projekte të këtij lloji. Unë shpresoj shumë që projektet me UNICEF-in të vazhdojnë dhe falenderoj shumë personalisht edhe z.Roberto për angazhimin dhe kujdesin që tregon ndaj qytetit të Korçës.

Përfaqësues i UNICEF shpreh keqardhjen që nuk mund të shprehet në gjuhën shqipe, megjithatë thekson se do të flasë shumë shkurt për një prezantim të përgjithshëm të projektit në fjalë. Ai mendon se Kryetari i Bashkisë bëri një përmbledhje shumë të saktë të gjithë marrëdhënies dhe bashkëpunimit të lidhur tashmë mes Bashkisë Korçë dhe UNICEF-it dhe se sot ishte rradha e nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi nën titullin "Bashki Mike e Fëmijëve" mes Bashkisë së Korçës dhe UNICEF Shqipëri. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje në Korçë do të kthehem shpesh herë jo vetëm si përfaqësues i UNICEF, por më tepër si një qytetar i thjeshtë që e pëlqen kaq shumë Korçën thekson ai. Falenderime shkojnë për bashkëpunëtorët e ekzekutivit që kanë qënë gjithmonë të gatshëm për bashkëpunim, por edhe për Këshillin Bashkiak për kohën dhe hapësirën.

Përfaqësuese e UNICEF: Iniciativa nuk është thjesht e UNICEF Shqipëri, por është një iniciativë e mbarë komuniteteve ku operon UNICEF, të cilën jemi përpjekur ta bëjmë sa më të

përshtatshme për kontekstin e Shqipërisë. Bashkia e Korçës është Bashkia e parë që e implementon këtë iniciativë, sepse kemi gjetur frymën e bashkëpunimit, kemi gjetur shumë gjëra të krijuara shumë përpara asaj që ne kishim menduar. Kjo iniciativë vjen me strategjitë e saj kryesore siç janë: krijimi i mekanizmave dhe proceseve gjithëpërfshirëse për fëmijët; planifikimi dhe buxhetimi strategjik me fokus fëmijët; monitorimi i vazhdueshëm dhe mbledhja e të dhënave për fëmijët; marrja e masave aktive për të reduktuar/eliminuar diskriminimin; komunikimi i vazhdueshëm, ndërgjegjësimi dhe advokimi për të drejtat e fëmijëve. Në praktikë, kjo iniciativë është një bashki, komunitet ose njësi administrative apo çdo rend i qeverisjes vendore, në të cilën zërat, nevojat, prioritetet dhe të drejtat e fëmijëve janë pjesë përbërëse e politikave, programeve dhe vendimeve publike. Vizioni është që çdo fëmijë dhe i ri të shijojë fëmijërinë e tij dhe të arrijë potencialin e plotë brenda bashkive/komuniteteve të tyre. Fushat kryesore të kësaj ndërhyrjeje janë qeverisje e mirë lokale e bazuar në: sisteme të përmirësuara për politikbërje, buxhetim dhe monitorim; planifikime bazuar në evidencë dhe monitorim të vendimeve lokale; angazhime efikase të përfituesve dhe aktorëve të tjerë. Mjedise të sigurtë, të pastër dhe të mbrojtur: lëvizja e sigurtë dhe e pavarur; mjedise të pastra dhe të gjelbërta. Mjedis mundësues: gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja; inovacioni dhe teknologjia. Loja dhe koha e lirë: hapësira të aksesueshme për lojë dhe kohën e lirë; standardet dhe mekanizmat e sigurisë. Kjo iniciativë nuk identifikon një mekanizëm të specifikuar, pra ndërhyrje në këtë apo atë shkollë, por është përgjithësuese se përfshin këdo që dëshiron të bëhet pjesë e këtij projekti. Për të mos u zgjatur unë uroj të shihemi përsëri për biseda dhe iniciativa të tjera në favor të fëmijëve, po edhe të grupeve të tjera shoqërore dhe ju falenderoj për mundësinë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Për të vazhduar aty ku e lamë, nga këshilltarët ka diçka për të shtuar?

Këshilltari I.Nikaj: Ndoshta Drejtoria Juridike ka ndonjë shpjegim mbi shoqëritë e përcaktuara në material.

Ekzekutivi A.Dishnica: Të gjitha shoqëritë e cituara janë shoqëri tregëtare.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ne kemi një eksperiencë në lidhje me shoqëritë, siç është marrëveshja e mbetjeve dhe njësoj funksionon. Tek ajo e mbetjeve janë të 6 bashkitë e Qarkut, ndërsa këtu jemi vetëm ne tani që do të bashkohemi me të tjerë.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Si ka funksionuar ai bashkimi i parë me 6 bashkitë? Se di tani unë personalisht jam pak skeptik për nisma të tilla, për cënimin që mund të na ndodhë ne, po gjithsesi pikëpamjet janë personale pastaj.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ideja për këtë organizim nuk është se ka erdhur nga ne si propozim, unë e thashë që në fillim, që është një reformë që po tentohet të realizohet në nivel kombëtar dhe propozimi ka erdhur nga Ministria. Nuk besoj se qëllimi i Ministrisë pas këtij propozimi është që të dëmtojë edhe ato modele që tashmë janë sukses si rasti ynë. Patjetër që ka risqe, unë i thashë vet që në fillim dhe këto pyetje në takime i kam ngritur edhe unë, por sigurisht që çdo bashki do të mbajë përgjegjësitë e saj për territorin që mbulon, të paktën në pjesën e menaxhimit të

tarifave. Do vëmendje, do kujdes, qëllimi nuk është të prishet punë, qëllimi është të përmirësohet, megjithatë vendimmarrja është e juaja pastaj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nëse nuk ka ndonjë diskutim nga këshilltarët, kalojmë në votim. Me sa vota kalon ky material?

Ekzekutivi A.Dishnica: Me 50% të votave.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 21

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 4

Pika 8 e rendit të ditës

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT KËSHILLIMOR PËR DHËNIEN E MEDALJEVE DHE TITUJVE VENDORË TË NDERIT.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Në lidhje me këtë pikë mund të themi se për çdo fushë na duhet nga një Komitet Këshillimor, po për mbledhjen e sotme kemi dy kërkesa për t'u trajtuar, ku në ngritjen e këtij Komiteti përveç tre emrave që duhet të jenë brenda Këshillit duhen dhe dy anëtarë të tjerë jashtë tij, konkretisht dy përfaqësues nga mjekësia. Tani propozimet për anëtarët nga jashtë janë doktoreshë Vlefa dhe doktoreshë Gerla që për koïcidencë është edhe përfaqësuese në fushën e mjekësisë edhe pjesë e Këshillit tonë. Ndërkohë anëtarët e tjerë janë ata që ne kemi propozuar edhe më parë, znj. Ana Verushi, znj. Irena Nikaj dhe z.Pandi Bello. Kemi për sot dy kërkesa, një kërkesë për të ndjerin doktorin Kujtim Shabani dhe një kërkesë tjetër për doktor Ilia Ballauri.

Këshilltare I.Nikaj: Mendoj Kryetar se na duhet më tepër informacion si Komision për të shqyrtuar dhe për të vendosur mbi këto tituj më pas sigurisht edhe një listë që e kemi thënë edhe më parë me titujt dhe emrat e personave që iu kemi dhënë më parë këto tituj.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Po patjetër, do i diskutojmë edhe dokumentacionet, por për momentin nuk mund të lemë një punë dhe të zemë një punë tjetër, më vonë flasim dhe vendosim mbi nevojat e Komisionit. Mos pengojmë punën e dhënies së një titulli se nuk kemi listën me emrat e mëparshëm dhe krijojmë vonesa.

Këshilltare A.Verushi: Nuk duam vërtetë të krijojmë pengesa, por ideja është Kryetar që duhet patjetër që këto kërkesa të kenë një dokumentacion të plotë, për ta bërë edhe punën dhe vlerësimin tonë më të saktë në titujt që do të jepen.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, ju si Komision shqyrtojini kërkesat njëherë dhe për atë që nuk ka erdhur e plotë kërkonti më tepër informacion. Tani për këtë Komitet Këshillimor ka ndonjë sugjerim, diçka për të shtuar para se të kalojmë në votim?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Fjalën ma ka kërkuar edhe aktori Guri Koço, si person i afërt me doktorin e ndjerë Kujtim Shabani, mund të vazhdoni.

Aktori Guri Koço përmes një letre përcjell ndjeshmërinë e bashkëshortes së të ndjerit për vonesën në dhënien e titullit "Qytetar Nderi" dhe gjithë vlerësimet dhe opinionet që komuniteti që e rrethonte kishte për të.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Doja ta theksoja që nuk ka patur asnjë pengesë për dhënien e titullit përveç faktit të respektimit të afateve kohore që kërkon procedura.

Pika 9 e rendi të ditës

PREZANTIM "INICIATIVA BASHKI MIKE E FEMIJËVE (ADOLESHENTËVE)". UNICEF SHQIPËRI.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: E ezauruam këtë prezantim pak më parë.

Pika 10 e rendit të ditës

RAPORTI I MONITORIMIT JANAR-DHJETOR 2021.

Ekzekutivi D.Tabaku: Raporti i monitorimit është një raport i rëndësishëm jo vetëm për njësinë e vetëqeverisjes vendore por dhe për qytetarët. Ky raport tregon zbatueshmërinë e buxhetit dhe rezultatet e arritura të Bashkisë Korçë për periudhën janar – dhjetor 2021. Me normalizimin e pjesshëm të jetës së përditshme pas COVID-19, ky normalitet reflektohet edhe në jetën ekonomike si: rritjen e numrit të vizitorëve në qytetin e Korçës, rritja e turizmit, rritja e të ardhurave të mbledhura nga taksat dhe tarifat vendore etj. Për vitin 2021 buxheti fillestar i akorduar ka qenë në vlerën 1,666,477 lekë. Në zbatim të VKB nr.17 datë 04.02.2021 "Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2020 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2021, si dhe për një ndryshim në buxhetin e miratuar me VKB nr.147 datë 28.12.2020", VKB nr.31 datë 25.03.2021 "Për miratimin e fondit të rritjes së pagave për funksionin e arsimit parashkollor", si dhe VKB nr 53 datë 3.6.2021 "Për një ndryshim në VKB nr 147 datë 28.12.2020, buxheti i Bashkisë Korçë shkon në vlerën 1,931,044 mijë lekë.Gjithashtu theksojmë se gjatë vitit 2021 janë miratuar projektet me financim 100% të IADSA në vlerën 10,342 mijë lekë. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2021, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë janë rishpërndarë fondet midis zërave të shpenzimevebrenda të njëjtit program. Në periudhën

janar – dhjetor realizimi i shpenzimeve ka qënë në vlerën 1,484,215 lekë ose 77% në raport me planin vjetor në vlerën 1,931,044 lekë. Përqindjen e realizimit më të lartë ndaj planit të periudhës për periudhën janar – dhjetor 2021 e kanë programet të listuara si më poshtë: pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm:96%; menaxhimi i mbetjeve:95%; rrjeti rrugor rural:91%; arsimi i mesëm i përgjithshëm:89%; kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara: 89%; arsimi i mesëm i përgjithshëm:89%; sport dhe argëtim:88%; arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor: 86%; shërbime publike vendore:84%; çështje financiare dhe fiskale:80%; transporti publik:80%; kujdesi social për familje dhe fëmijë:80%. Treguesit e performancës mund t'i gjeni të plotë edhe në faqen 21 të raportit dhe në faqen 31 dhe 32.

Pika 11 e rendit të ditës

INFORMACION PËR VENDIMARRJEN DHE PERFORMANCËN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2021.

Sekretare E.Naçi: Ky është një raport i hartuar nga unë, me kërkesë nga projekti "Bashki të Forta", ku pasqyrohet për këshilltarët informacioni mbi numrin e mbledhjeve, vendimeve, konsultimeve e kështu me rradhë. Këshilli i Bashkisë Korçë për vitin 2021 ka pasur një aktivitet të plotë në vendimarrje dhe në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin. Edhe pse një vit i vështirë për shkak të pandemisë Covid-19, kemi mundur të arrijmë disa objektiva madhore në kryerjen e funksioneve duke u mbështetur te ligji 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe legjislacioni sektorial për fusha të ndryshme të vetëqeverisjes vendore. Duke qënë se Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues, jemi munduar të ushtrojmë këto role me mundësitë disi të kufizuara në kohë pandemie por gjithësesi me angazhim dhe përkushtim. Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit po mundohemi në mënyrë të përmbledhur të japim aktivitete kryesore të zhvilluara sipas kategorive. Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë: Gjate vitit 2021 jane realizuar në total 15 mbledhje të Keshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 3 jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë. Në total janë miratuar 157 vendime prej të cilave 4 të pa konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë. Janë realizuar 15 mbledhje komisioni. Për shkak të pandemisë, këtë vit janë zhvilluar 6 mbledhje on-line dhe 9 mbledhje me takime fizike në sallë. Duhet theksuar që të gjitha mbledhjet e Këshillit janë zhvilluar në transmetim live nëpërmjet faqes së Facebook, ç'ka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të japë dhe mendimet dhe sugjerimet e tij për vendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar. Gjithashtu gjatë vitit 2021 kemi miratuar një plan aktivitetesh të shoqëruar me buxhetin përkatës të dedikuar vetëm për Këshillin në mënyrë që të realizoheshin aktivitetet e planifikuara me nje fond prej 1.618.000 lekë, i cili është ekzekutuar në masën 17.4%. Në procesin e shqyrtimit dhe implementimit të këtyre rregulloreve Këshilli është asistuar nga Projekti "Bashki të Forta" i cili do vazhdojë edhe për këtë vit të asistojë për të bërë të mundur vazhdimin e implementimit të këtyre standarteve në mënyrë që të rritet roli i Këshillit të Bashkisë. Në lidhje

me rolin përfaqësues të Këshillit për vitin 2021, si u theksua më sipër duke marrë parasysh situatën për shkak të pandemisë Covid-19, është synuar që komunikimi dhe marrja e mendimeve të komunitetit të realizohet nëpërmjet komunikimit kryesisht nëpërmjet publikimit dhe marrjes së mendimeve nëpërmjet rrjeteve sociale. Për këtë qëllim faqja e Facebook-ut e Këshillit Bashkiak Korçë e cila ka qënë aktive që në vitin 2020, ka publikuar vazhdimisht aktivitetet të Këshillit dhe realizuar transmetimin livestream të mbledhjeve, gjë e cila, tashmë është pjesë e procedurave të zhvillimit të mbledhjeve. Në faqen Facebook kanë erdhur shumë mendime dhe sugjerime nga komuniteti. Anëtarët e KB, janë fokusuar gjithashtu edhe në takimet direkte me banorët e Bashkisë Korçë dhe përcjelljen e mendimeve të tyre në mbledhjet e komisioneve dhe të KB. Në zbatim të Rregullores së Konsultimeve Publike është realizuar sondazhi on line për prioritetet e qytetarëve për PBA 2022-2024. Duke respektuar masat kufizuese për shkak të pandemisë, konsultimi publik përmes sondazhit on line, solli mendimin e qytetarëve pranë KB. Gjithashtu në datën 16 nëntor është realizuar nga Këshilli Bashkiak Korçë një town hall ku u diskutua mbi paketën fiskale 2022, projekt-buxhetin 2022-2024 dhe mekanizmat e komunikimit të Këshillit Bashkiak. Në të morën pjesë 41 persona, nga të cilët 23 meshkuj, 17 femra. Përpara townhall u realizuan takime në lagje dhe takime në Njësitë Administrative. Gjatë konsultimeve publike për PBA 2022-2024, dolën 7 rekomandime nga të cilat 4 u reflektuan në buxhetin e vitin 2022. Në zbatim të rregulloreve të miratuara është vënë në funksionim regjistri fizik i ankesave/kërkesave dhe një regjistër fizik i iniciativave/peticioneve ku regjistrohen dhe evidentohen të gjitha ankesat/kërkesat e mbërritura në drejtim të Këshillit të Bashkië. Konkretisht janë depozituar në total 23 kërkesa drejtuar Këshillit Bashkiak. Janë trajtuar në bashkëpunim me ekzekutivin 23 kërkesa dhe në të gjitha rastet janë informuar qytetarët. Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruara nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt-vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2021 u realizuan dhe u paraqitën në Këshill 13 informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të bëra nga vetë Këshilli.

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Ka diçka nga këshilltarët për të shtuar?

Pika 12 e rendit të ditës

INFORMACION. LISTA E TREGUESVE TË SISTEMIT TË MATJES SË PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE. RAPORTI I PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE. RAPORTI I PERPUTHSHMERISË SË MONITORIMIT TË PERFORMANCËS NË NIVEL BASHKIE. PROJEKTI BASHKI TË FORTA

Kryetari i Këshillit E. Nexhipi: Pika në vijim lidhet me materiale dhe informacione që ne na vijnë nga projekti Bashki të Forta, janë disa materiale unë besoj se ju i keni marrë dhe i keni lexuar në formë elektronike me e-mail. Flitet për disa raporte dhe është dërguar edhe një material në formë përmbledhjeje për Kryetarin e Këshillit ku duhet të shpjegojë se raport i hartuar ka të bëjë me performancën e shërbimeve që ofrojnë bashkitë. Raporti është bazuar në informacionin e mbledhur dhe raportuar nga vetë bashkitë si një kërkesë ligjore. Ai përmbledh të dhëna të

treguesve të performancës së shërbimeve që ofrojnë bashkitë. Në mënyrë që të mund të hartohet një raport që përfaqëson bashkitë janë përdorur tregues performance të cilat gjenden apo përdoren nga shumica e bashkive. Raporti nxjerr në pah se ku janë bashkitë në zbatimin e standardeve minimale ligjore të shërbimeve që ofrojnë dhe shumë interesante të diskutohet është fakti sesi qëndrojnë bashkitë sot kundrejt disa shërbimeve që janë marrë nga qeveria qendrore në vitin 2016 si menaxhimi i kanaleve vaditëse dhe kulluese; menaxhimi i pyjeve dhe kullotave; mbrojtja nga zjarri etj. Të tjera të dhëna sigurisht mund t'i lexoni në materialet e marra për të mos e zgjasur më tepër këtë mbledhje. Ajo që doja t'iu thoja është se nga ana jonë është publikuar në faqen e Facebook-ut një sondazh, të cilin mund ta plotësoni edhe shpërndarë edhe ju.

Pika 13 e rendit të ditës

INFORMACION. SHËRBIMI I PASTRIMIT NË BASHKINË E KORÇËS.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Nga ekzekutivi ka diçka për të shtuar përtej materialit që kemi marrë si informacion.

Ekzekutivi L.Gjançi: Përtej informacionit të dorëzuar mund të them se veprimtaria e kompanisë së pastrimit dihet, vërehet çdo ditë. Mendoj se kemi bërë një punë të mirë me një grafik të përcaktuar për gjithë fshatrat, por edhe me ndarjen e mbetjeve. Në landfill është arritur një rezultat shumë i mirë, i cili na bën ta parashikojmë menaxhimin e tij për 20 vitet e ardhshme. Materialin ju e keni, aty janë të shpjeguara të gjitha nuk e di çfarë pyetje mund të keni patjetër që jam këtu për t'u përgjigjur.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Si po vijon puna në landfill? Flas jo vetëm për bashkinë tonë, por në përgjithësi. Unë doja të diskutonim pak edhe për situatën e rrugicave kur bie borë, besoj se të gjithë e kemi parë që në ditët kur ka rreshje bore, kalimi në lagjet 1, 2 apo 3 është i vështirë, si mendoni se mund të zgjidhet kjo situatë? Nuk po them që është një problem i gjithë vitit, por për ato ditë që Korça ka rreshje bore shkaktohet një problem i madh për banorët dhe kalimtarët në këto lagje.

Ekzekutivi L.Gjançi: Sa i përket landfillit ka patur vështirësi fillimisht me bashkitë e tjera, konkretisht Bashkia e Pogradecit ka qënë më e parregullta, por tani kanë filluar të paguajnë rregullisht. Kanë funksionuar 2 qendra transferimi, vetëm Pogradeci i sjell direkt në landfill mbetjet. Projekti me palën gjermane vazhdon, nuk ka përfunduar, sigurisht duke shpresuar për përmirësim i shërbimit akoma edhe më shumë. Ndërsa rreth shqetësimit tuaj për borën patjetër që e di edhe unë se çdo ditë më pyesin njerëz se çfarë ndodh me këto rrugë. Gjithçka varet nga buxheti, sepse pastrimi i atyre rrugicave kërkon mjete pastrimi specifike, të cilat janë të shtrenjta dhe sigurisht që rritet kostoja e shërbimit.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Le të flasim për këtë buxhet që kemi, vetëm këto para kemi, kaq mund të bëjmë. Atëherë të kemi një zgjidhje dhe model me situatën aktuale që kemi.

Ekzekutivi L.Gjançi: Ne vitin tjetër kemi kontratë të re dhe do të mundohemi të gjejmë një zgjidhje edhe për këtë problem.

Këshilltari E.Mitre: Diçka që unë doja të shtoja është pjesa e pastrimit të borës para shkollave dhe një dëmtim të koshave të shkollave, çfarë mund të bëhet, sa mund të zëvendësohen?

Ekzekutivi L.Gjançi: Shqetësim i drejtë, ju falenderoj, do e kem parasysh këtë problem.

Këshilltari A.Verushi: Meqënëse jemi në këtë pjesën e pastrimit, unë do doja t'iu kushtoj pak vëmendje edhe mirëmbajtjes së varrezave, janë disa rregullime të domosdoshme aty, vendosja e bordurave apo hedhja e dheut, nuk e di sa i keni parasysh.

Ekzekutivi L.Gjançi: Po, e kam parasysh, keni të drejtë.

Këshilltari J.Deli: Edhe unë doja të shtoja se lagjia 3 nuk e ka pastrimin përditë.

Ekzekutivi L.Gjançi: Në dijeninë time pastrimi ndodh çdo ditë megjithatë patjetër që duhet parë.

Këshilltari I.Nikaj: Unë kam vlerësim për pjesën e pastrimit dhe mendoj se një interes ka edhe përpunimi i mbetjeve që në burim, sepse një pjesë e tyre përdoret edhe për kultivimin e kulturave bujqësore në format e plehrave kimikë dhe pse mos t'i mbështesim këto mënyra shumë të mira zhvillimi.

Pika 14 e rendit të ditës

INFORMACION NGA DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kemi edhe një pikë, informacion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të cilën propozoj ta lemë për herën tjetër.

Pika 15 e rendit të ditës

KËRKESA –ANKESA TË QYTETARËVE.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Kërkesa e parë lidhet me problematika të lagjes 14, kërkesa është shpërndarë besoj është parë nuk ka nevojë ta lexoj, unë një pyetje kisha për ekzekutivin, ka mbaruar procesi i legalizimit aty?

Ekzekutivi L.Gjançi: Vetëm një pjesë është legalizuar, ndërkohë ne vjet kemi bërë një investim në këtë zonë, por rruga për të cilën bën fjalë kërkesa ka një ndarje e cila do të bëhet gradualisht. Ne kemi bërë 80% të zonës aty dhe ka ngelur vetëm një pjesë e vogël, por sigurisht futet në prioritetet tona.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Edhe unë mendoj se mund të zgjidhet si problem.

Pika 16 e rendit të ditës

PIKA TË NDRYSHME.

~~Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Tek kjo pikë, kemi një qytetar prezent, po i jap fjalën ta dëgjojmë shqetësimin e tyre.~~

Qytetari: Shqetësimi im qëndron në problemet e infrastrukturës ende të pazgjidhura në lagjen 4, mbrapa shkollës "Nuçi Naçi", diçka është bërë aty, por situata ngelet akoma e pazgjidhur dhe problem për ne banorët aty.

Ekzekutivi L.Gjançi: E kam parasysh, e kemi në plan ndërhyrjen në atë pjesë.

Këshilltare I.Nikaj: Përpara se të përfundojmë, meqënëse jemi tek pika të ndryshme, unë do ndaja shqetësimin tim jo vetëm për pastrimin e rrugicave që u përmend pak më parë, por edhe për ndihmën që duhet t'i japim ekipit tonë të futbollit, por edhe për mungesën e ndarjes gjinore nga ana e Bashkisë, tek programet e saj konkretisht nuk ka një mbledhje të statistikave gjinore për të gjitha fushat e shumë pika të tjera të barometrit gjinor. Mendoj se është e rëndësishme të diskutohen çështje të tilla.

Kryetari i Këshillit E.Nexhipi: Dakort, nëse nuk ka diçka tjetër për diskutim, ju falenderoj për pjesëmarrjen!

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

KRYETARI

ERJON NEXHIPI

